



TURIZMI NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM NË KOMUNAT ZUBIN POTOK DHE PEJË



Botues
Instituti për zhvillim ekonomik (InTER)

Për botuesin
Dragisa Mijacic

Autorë
Jovana Jakovljevic
Dragiša Mijacic
Nol Krasniqi

Viti
2020

Publikimi është realizuar në kuadër të projektit të financuar përmes grantit të Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi ekskluzive e autorit dhe në asnjë rast nuk përmban qëndrime të Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur.



**TURIZMI NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT
TË QËNDRUESHËM NË KOMUNAT ZUBIN
POTOK DHE PEJË**

Shkurt 2020

PËRMBAJTJA

HYRJE	1
ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE TURIZIMI I QËNDRUESHËM	2
Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm	2
Turizmi i qëndrueshëm	4
POLITIKAT LOKALE DHE REGJIONALE PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT	7
Komuna e Zubin Potokut	7
Komuna e Pejës	8
Bashkëpunimi mes komunave Pejë dhe Zubin Potok	9
TURIZMI NË KOMUNËN E ZUBIN POTOKUT	11
Karakteristikat themelore gjeografike	11
Iniciativa për zhvillimin e turizmit në Zubin Potok - Outdoor In	13
Potencialet turistike dhe produktet	14
Ndjekja e trendeve dhe nevojave të turistëve	18
TURIZMI NË KOMUNËN E PEJËS	21
Potencialet dhe produktet e turizmit	21
NDIKIMI I TURIZMIT NË DESTINACION	27
PËRFUNDIM	29

HYRJE

Vitet e fundit, turizmi është bërë sektor udhëheqës i ekonomisë në krahasim me sektorët e tjerë, duke e bërë atë sektorin me rritje më të shpejtë në botë. Megjithatë, zhvillimi i turizmit është dukshëm më i kushtëzuar se veprimtaritë e tjera me cilësinë e mjedisit, vlerat natyrore dhe kulturore të tij dhe me karakteristika të tjera. Mbi të gjitha, shkalla e ruajtjes dhe atraktiviteti i mjedisit reflektohet drejtpërdrejt në mundësitë për zhvillimin e turizmit në një zonë të caktuar, që do të thotë se turizmi, përveç përgjegjësisë së tij për mjedisin ekonomik, shoqëror dhe kulturor, bart edhe përgjegjësi të konsiderueshme për mjedisin natyror.

Zhvillimi i turizmit bazuar në krijimin e një marrëdhënieje miqësore mes rrethinës natyrore dhe transformimit të saj në një destinacion tërheqës konsiderohet si zhvillim i përgjegjshëm. Për më tepër, turizmi ka për detyrë të arrijë një ekuilibër ku plotësimi i nevojave aktuale të turistëve nuk do të rrezikojë nevojat e brezave të ardhshëm, duke arritur kështu një zhvillim të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm në mënyrë që të ruaj të gjitha vlerat domethënëse në mjedis.

Në mënyrë që të pengohet degradimi i destinacioneve turistike, gjatë zhvillimit të turizmit duhet të identifikohen ndryshimet dhe gjithnjë të luftohen faktorët që i sjellin ato, por gjithashtu duhet të vendosen bazat për zhvillimin e turizmit, ndikimi i të cilave në mjedis gjithnjë do të mbikëqyret. Së këndejmi, në mënyrë që turizmi të jetë i qëndrueshëm, në këtë zhvillim duhet të përfshihen të gjitha palët, duke filluar nga komunitetet lokale, turistët, sektori i ndërtimit që është përgjegjës për ndërtimin dhe rindërtimin e objekteve turistike e deri te agjencitë turistike që i sjellin turistët.

Megjithatë në komunat Zubin Potok dhe Pejë tashmë është konfirmuar ekzistenca e formave të caktuara të turizmit, me një tendencë për të zhvilluar dhe rritur edhe më shumë numrin e turistëve nga viti në vit, qëllimi i kësaj analize është të sqarojë konceptin e turizmit të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm, si dhe rëndësinë e tij për zhvillimin e qëndrueshëm. Përveç sqarimit të konceptit të turizmit të qëndrueshëm, kjo analizë do të përfshijë edhe prezantimin e potencialeve dhe produkteve ekzistuese të turizmit, politikave lokale dhe rajonale të zhvillimit të turizmit, si dhe ndikimin e turizmit në këto destinacione.

Analiza është bërë në kuadër të projektit "Turizmi i qëndrueshëm në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm", i zbatuar nga InTER në bashkëpunim me OJQ Marimangat dhe partnerët e mediave "Crno beli svet" dhe TELEGRAFI. Projekti është mbështetur financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) dhe është zbatuar nga 1 korriku deri më 15 shkurt 2020. Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë artikull janë përgjegjësia e vetme e autorit dhe nuk pasqyrojnë në asnjë mënyrë pikëpamjet e KFOS-it.

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE TURIZIMI I QËNDRUESHËM

Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm

Nuk ka një përcaktim të pranuar në mënyrë universale të zhvillimit të qëndrueshëm. Sidoqoftë, përkufizimi më i shpeshtë në literaturë është ai i raportit “Ardhmëria jonë e përbashkët”, i cili, me kërkesë të Kombeve të Bashkuara, u hartua në vitin 1987 nga Komisioni Botëror për Mjedis dhe Zhvillim. Ky përkufizim është si në vijim: Zhvillimi i qëndrueshëm është zhvillim që plotëson nevojat e së tashmes në një mënyrë që nuk rrezikon aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre”.¹

Zhvillimi i qëndrueshëm është një nga fenomenet më të njohura të ditëve të sotme, veçanërisht në kontekstin e veprimtarive të Kombeve të Bashkuara (KB), gjegjësisht të Agjendës së vitit 2030 për zhvillim të qëndrueshëm. Ai është i përqendruar në balancimin e qëllimeve të shumta të zhvillimit ekonomik, mjedisor dhe shoqëror, si dhe në rëndësinë e komponentit institucional. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së shpalli vitin 2017 si **Vitin e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit**, me qëllimin të mbështetjes së ndryshimeve në politikën e zhvillimit të turizmit, në mënyrë që të kontribuojë në arritjen e qëllimeve globale të zhvillimit të qëndrueshëm.

Synimet u pajtuan dhe u miratuan në konferencën RIO + 20 të vitit 2012 dhe zyrtarisht hynë në fuqi në fund të vitit 2015² në një seancë të OKB-së. Zbatimi i këtyre synimeve në nivel global filloi zyrtarisht në 1 janar 2016. Qëllimet e përcaktuara globale për zhvillimin e qëndrueshëm janë:

- Mos të ketë varfëri (*no poverty*) – qëllimi është që të çrrënjosen të gjitha llojet dhe format e varfërisë në planet deri në vitin 2030;
- Mos të ketë uri (*zero hunger*) – çrrënjosja e definuar qartë e të gjitha formave të urisë dhe e konsumit të pamjaftueshëm të elementëve ushqyes në mbarë planetin;
- Shëndet i mirë dhe mirëqenie (*good health and well-being*) – përmes këtij qëllimi tentohet të arrihet shëndet i mirë dhe mirëqenie për të gjithë banorët e planetit në çdo moshë të tyre;
- Shkollimi cilësor (*quality education*) – arritja e shkollimit cilësor në të gjitha nivelet e procesit arsimor;
- Barazia gjinore (*gender equality*) – edhe pse kjo barazi është rritur dukshëm në dekadat e fundit, megjithatë edhe më tej ka mundësi për përmirësim.

¹ Our Common Future, Brundtland Report, 1987, i qasshëm në <https://bit.ly/2uANL6b>

² Tourism and Sustainable Development Goals, i qasshëm në <https://bit.ly/3aMQ0DT>

- Uji i pastër dhe pastërtia (*clean water and sanitation*) – konsiderohet se e prezantojnë bërthamën e zhvillimit të qëndrueshëm. Llogaritet që 91% e popullsisë botërore kanë qasje në ujin e pastër të pijshëm që paraqet përmirësim prej 9% sa ka qenë në vitin 2000.
- Energjia e pastër dhe e qasshme (*affordable and clean energy*) – parqet thelbin e çdo qëllimi për zhvillim të qëndrueshëm dhe apelon për promovimin dhe shfrytëzimin e burimeve të pastra dhe të ripërtërishme të energjisë në tërë botën.
- Puna me dinjitet dhe zhvillimi ekonomik (*decent work and economic growth*) – apelon për zhvillim përfshirës dhe të qëndrueshëm ekonomik, si dhe rritje që është jashtëzakonisht i rëndësishëm për zhvillim të qëndrueshëm.
- Industria, inovacionet dhe infrastruktura (*industry, innovation and infrastructure*) – e siguron bazën materiale për zhvillim të qëndrueshëm, gjegjësisht kërkon përparimin e industrisë dhe infrastrukturës përmes inovacioneve.
- Barazia/zvogëlimi i pabarazisë (*reduce inequalities*) – ka për qëllim zvogëlimin e të gjitha llojeve të pabarazisë në shoqëri.
- Qytetet dhe bashkësitë e qëndrueshme (*sustainable cities and communities*) – supozohet se deri në vitin 2030, 6 prej 10 banorëve do të jetojnë në qytete dhe se për këtë shkak synohet të kemi qytete dhe bashkësi të qëndrueshme.
- Shpenzimet dhe prodhimet e përgjegjshme (*responsible consumption and production*) – ky qëllim është i lidhur drejtpërsëdrejti me zhvillimin ekonomik që është vendimtar për zhvillimin e qëndrueshëm.
- Klima (*climate action*) – thërret për luftë kundër ndryshimeve klimaterike respektivisht për zvogëlimin dhe eliminimin e shkaktarëve që i kanë nxitur këto ndryshime.
- Jeta nënujore (*life under water*) – ka të bëjë me resurset oqeanike, detare dhe bregdetare, si dhe shfrytëzimin e mbrojtjen e tyre.
- Jeta në tokë (*life on land*) – ka të bëjë me ruajtjen e diversiteteve të formave jetësore në tokë, gjegjësisht mbrojtjen e tyre, kryesisht nga ndikimi antropogjen.
- Paqja, drejtësia dhe institucionet e fuqishme (*peace, justice and strong institutions*) – hynë në pjesën sociale të zhvillimit të qëndrueshëm dhe konsiderohen edhe si bërthama e tij.
- Partneriteti (*partnership for the goals*) – promovon partneritet në nivelin global me qëllim të realizimit të qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm nënkupton zhvillim ekonomik të balancuar, zhvillim social dhe kulturor pa e rrezikuar mjedisin jetësor, me të cilin breznive të ardhshme do tu mundësohet që të zhvillohen në atë nivel ose nivel më të lartë. Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm e ka marrë afirmimin e vetë të plotë në Konferencën e OKB-së për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe zhvillim në Rio De Zhaneiro në vitin 1992, ku qartas është theksuar se mbrojtja e mjedisit jetësor duhet që pa tjetër të jetë pjesë integrale e zhvillimit të gjithmbarshëm njerëzor. Sipas kësaj, çdo veprimtari (pra edhe turizmi) duhet që me rastin e planifikimit dhe nxjerrjes së vendimeve maksimalisht t'i merr parasysh dhe t'i respektoj

kërkesat për mbrojtjen e mjedisit jetësor, ashtu që zhvillimi të jetë i përhershëm, sepse në të kundërtën mund të ndodhë degradimi, por edhe vetëshkatërrimi i plotë.³

Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm nuk duhet kuptuar si definicion rreptë i përcaktuar, por vetëm si proces i ndryshimeve në raportet që vendosen në mes të sistemeve dhe proceseve shoqërore, ekonomike dhe natyrore, duke marrë parasysh se koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm bazohet mu në këta tre komponentë thelbësor.

- qëndrueshmëria ekologjike, e cila siguron që zhvillimi të jetë në përputhje me proceset vitale ekologjike, me shumëllojshmërinë biologjike si dhe me resurset biologjike.
- shumëllojshmëria sociale dhe kulturore, e cila siguron që zhvillimi të jetë në përputhje me vlerat kulturore dhe tradicionale të bashkësive njerëzore dhe kontribuon në përforcimin e integritetit të tyre.
- qëndrueshmëria ekonomike, e cila siguron që zhvillimi ekonomik të jetë efikas dhe me mundësi të hapura që edhe breznitë e ardhshme t'i shfrytëzojnë resurset.⁴

Ky proces mund të realizohet vetëm shkallë-shkallë, sepse kërkesat që parashtrihen para shoqërisë njerëzore janë shumë komplekse. Fjala është, në radhë të parë, për formimin e vetëdijes së re ekologjike, për rritjen e përgjegjësisë së administratës shtetërore, për revidimin gjegjës të rregullimit ekzistues ekonomik dhe juridik, si dhe për përfshirjen më të madhe të ekspertëve për zgjidhjen e problemeve aktuale të mbrojtjes së mjedisit jetësor.⁵

Turizmi i qëndrueshëm

“Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit i plotëson nevojat e turistëve dhe nikoqirëve të tyre, duke mbrojtur dhe forcuar mundësitë e zhvillimit. Një zhvillim i tillë i turizmit kërkon të arrijë menaxhimin e burimeve në atë mënyrë që nevojat ekonomike, sociale dhe estetike të plotësohen duke ruajtur integritetin kulturor, proceset themelore ekologjike, biodiversitetin dhe sistemet jetësore.”

Organizata Botërore e Turizmit

Sipas interpretimeve të Organizatës Botërore të Turizmit dhe Programit të OKB-së për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor, turizmi i qëndrueshëm e nënkupton zhvillimin e kësaj veprimtarie me të cilën respektohen dhe realizohen nevojat e turistëve, si bartës të kërkesave dhe lëmenjve turistikë, si bartës të ofertave, dhe se gjatë kësaj procedure të mos dëmtohet mundësia që qëllimet ekonomike, shoqërore dhe ekologjike të zhvillohen në nivelin e njëjtë apo më të lartë në periudha e ardhshme. Me fjalë tjera, koncepti i zhvillimit të

³ Turizmi dhe mjedisi jetësor, Joviçiq, D., 2000 Beograd, Fondi Andrejeviq.

⁴ The Three Dimensions of Sustainable Development: environment, economy and society, grup autorësh, 2018, Universiteti i Nishit, i qasshëm në: <https://bit.ly/310VHJM>

⁵ Turizmi dhe mjedisi jetësor, Joviçiq, D., 2000 Beograd, Fondacioni Andrejeviq.

qëndrueshëm duhet të jetë orientuesi kryesor në qeverisjen me veprimtari turistike e cila do ta mundësojë realizimin e qëllimeve ekonomike, shoqërore dhe estetike, me mbrojtjen e njëkohshme të vlerave kulturore, integritetit social, si dhe proceseve thelbësore ekologjike e diversitetit biologjik.⁶

Qëllimi kryesor i turizmit të qëndrueshëm është që turistëve t'u mundësohen kënaqësitë dhe arritja e diturive për karakteristikat natyrore, historike dhe kulturore të atij mjedisi, duke e ruajtur integritetin e destinimit, si dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies së komunitetit lokal. Zhvillimi i qëndrueshëm nuk guxon që ta ndalë zhvillimin e turizmit, por duhet ta mundësojë zhvillimin e tij ashtu që turistët t'i përjetojnë dhe t'i shohin ato që dëshirojnë, por të mos i shkatërrojnë ato gjëra nga të cilat ata janë tërhequr. Njëkohësisht, mjedisi shoqëror dhe kulturor i destinimeve turistike nuk guxon që të shkatërrohet apo të rrezikohet.⁷

Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit, në pjesën më të madhe, ka të bëjë në ndërtimin dhe zhvillimin e të ashtuquajturit ekoturizëm, me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së florës dhe faunës të atij mjedisi. Para se gjithash, është e nevojshme pjesëmarrja aktive e banorëve vendorë në aktivitetet e ruajtjes së mjedisit jetësorë. Aplikimi i këtij koncepti duhet të sigurojë rritjen e cilësisë së prodhimeve turistike në bazë të mbrojtjes së të mirave kulturore dhe natyrore e që në praktikë zbatimi i tillë kërkon qeverisje me burimet, të cilat do t'i orientojnë aktivitetet ekonomike në kuadër të parametrave ekologjikë. Zhvillimi i turizmit kërkon angazhimin e të gjitha palëve me interes për zhvillimin e turizmit dhe njëkohësisht është edhe garant i ruajtjes së vlerave ekonomike, ekologjike dhe kulturore, përveç kësaj, siç theksohet shpesh edhe e siguron zhvillimin ekonomik stabil, si dhe shpërndarjen e barabartë të mundësive jetësore.

Për tu jetësuar në praktikë koncepti i turizmit të qëndrueshëm, është e nevojshme që të vendoset model i atillë i zhvillimit, i cili do ta potencoj maksimalisht raportin pozitiv në mes të kategorive të qëllimeve të lartcekura (kategoria ekonomike, ekologjike dhe shoqërore), ku pasojat negative ekonomike për secilën do të zvogëloheshin në minimum. Qëllimet të cilat synohen njëkohësisht janë edhe parakushte për realizimin e tyre. Veçanërisht duhet theksuar se për dallim nga praktika e gjertanishme, qasja e re për zhvillimin e turizmit duhet që ta vë në plan të parë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit jetësorë, ndërsa dimensionin ekonomik e humb rëndësinë në aspektin relativ. Është fakt që turizmi i orientuar vetëm në aspektin ekonomik mund të jep rezultate të mira ekonomike për periudhë të shkurtër dhe t'i plotësoj shumë nevoja turistike, por nga ana tjetër do të prodhojë pasoja negative për mjedisin jetësor dhe jetën e popullsisë lokale.⁸

Nëse turizmi nuk planifikohet dhe me të nuk qeveriset sipas rregullave, mund të shkaktojë dëme afatgjata ekologjike, sociale, kulturore dhe ekonomike në mjedisin e destinacionit

⁶ Po aty.

⁷ Përgjegjësia ekologjike e turizmit, Nevena Belanski, 2018 Fakulteti i sportit dhe turizmit, Novi Sad, i qasshëm në <https://bit.ly/2uIjgLj>

⁸ Održivi razvoj turizma na primeru Vlasinske površine, Vidoje Stefanović i Nedžad Azemović, 2012 Škola biznisa, i qasshëm në: <https://bit.ly/2Rxxg9yQ>

turistik. Për këtë shkak, komunat Pejë dhe Zubin Potok, që janë lëndë e kësaj analize, dokumentet e veta strategjike i zhvillojnë ashtu që t'i kontribuojnë mënyrës së re të zhvillimit të turizmit, duke e potencuar si prioritet horizontal mbrojtjen e mjedisit jetësor.

POLITIKAT LOKALE DHE REGJIONALE PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT

Turizmi është degë multisektorale dhe ndërsektorale për shkak të ndikimit në të që kanë shumë sektorë. Nevojat për politikë konkrete dhe qasje strategjike afatgjate janë të mbrojtura jo vetëm me strategjitë që shumë lehtë mund të ndërrohen, por edhe me kornizën juridike ligjore. Në Kosovë ekziston Strategjia për zhvillimin e turizmit në nivelin qendror, dhe aktivitetet që ndërmerren me këtë sektor u nënshtrohen rregullave të caktuara ligjore, të cilat përfshihen në tre ligje: Ligji për turizmin; Ligji për investimet e huaja, dhe Ligji për trashëgiminë kulturore. Me këto ligje promovohet qeverisja efikase dhe politikat për tejkalimin e zbrazëtirave sektoriale.⁹

Si rrjedhojë e mosekzistimit të strategjisë qendror për zhvillimin e turizmit, planifikimet lidhur me zhvillimin e turizmit janë pjesë e Strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal 2019-2023, ku turizmi theksohet si një nga katër qëllimet strategjike të zhvillimit lokal.¹⁰ Strategjia paraqet dokument që bazohet në Planin e veprimit që ka për qëllim hartimin dhe koordinimin e politikave për zhvillim ekonomik në nivelin lokal në të gjitha komunat e Kosovës. Strategjia i definon mënyrat se si në nivelin lokal mund të realizohet qeverisja efikase, arsimim kualitativ, mbrojtje më e mirë e mjedisit, klimë më e përshtatshme për afarizëm etj., ashtu që të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së kushteve jetësore.

Në këtë dokument strategjik, turizmi, është theksuar si sektor shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik Përmes turizmit mund të tërhiqen investimet e huaja dhe investitorët e ri, si dhe mund të tërhiqet numër më i madh i turistëve, duke ua mundësuar qasjen në resurse dhe bukuri natyrore, shërbime, trashëgimi kulturore dhe në vlerat e tjera turistike. Duke pasur parasysh rëndësinë e zhvillimit të sektorit të turizmit, në këtë dokument theksohet se pushteti lokal duhet më tepër ta zhvillojë dhe ta promovojë këtë degë duke e vendosur në fokus zhvillimin e ekoturizmit si një formë që është duke u popullarizuar çdo ditë e më shumë në botë. Përveç kësaj, si sfida në lëmin e turizmit, këtu është theksuar edhe problemi i identifikimit të lëmenjve potencialë të turizmit, ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse në rajonet me potencial të theksuar turistik, por edhe promovimi i turizmit, ku veçanërisht theksohet mosekzistimi i qendrave lokale për informim turistik.

Komuna e Zubin Potokut

⁹ Development of Tourism Through Effective Policies and Legislations, Democracy for Development, 2017 Prishtina, i qasshëm në: <https://bit.ly/3aOWC4J>

¹⁰ Strategy for Local Economic Development 2019-2023, Ministry of Local Government Administration, 2018 Prishtina, i qasshëm në: <https://bit.ly/2tO1w1n>

Dokumenti themelor strategjik i komunës së Zubin Potokut që ka të bëjë me qasjen sistematike të zhvillimit të turizmit është Strategjia e zhvillimit të turizmit për periudhën 2015 – 2020. Në kuadër të këtij plani strategjik janë definuar edhe qëllimet kryesore të zhvillimit, si dhe prioritetet dhe masat e zhvillimit në periudhën kohore të vështruar. Lidhur me këtë, synohet që Kollashini i Ibrit të bëhet lokacion i njohur ndërkombëtarisht për turizëm aktiv që ofron përmbajtje atraktive, të cilat i tërheqin turistët nga e tërë bota, duke u fokusuar në zhvillimin e potencialeve për turizëm aktiv në lumin Ibër, liqenin e Ujmanit dhe në bjeshkën e Mokrës. Lidhja bjeshkë, liqe dhe lumë ofron mundësi unike për zhvillimin e turizmit të diversifikuar; produkt ky që në qenien e vetë unike do të jetë i spikatur në tregun turistik të Ballkanit. Me rastin e përcaktimit të qëllimeve strategjike në këtë dokument është marrë parasysh që aktivitetet të realizohen ashtu që të jenë të harmonizuara me prioritetet horizontale, siç janë: mbrojtja e mjedisit jetësor dhe ruajtja e biodiversitetit.

Përveç strategjisë zhvillimore, në mes të vitit 2015, komuna e Zubin Potokut e ka miratuar Deklaratën, me të cilën kjo komunë shpallet ekologjike. Deklaratën e ka pasuar edhe vendimi për futjen e bjeshkës së Mokrës nën mbrojtje. Vendimi u nxor me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe raporteve gjegjëse ndaj burimeve natyrore dhe mjedisit jetësorë. Me këtë vendim është paraparë që në periudhën dyvjeçare në bjeshkën e Mokrës të ndërpriten: prerja e paautorizuar e pyjeve, gjahu i paautorizuar dhe mbledhja jo e rregullt e frutave të malit, bimëve mjekuese dhe kërpudhave, shfrytëzimi i zonës së mbrojtur si kullotë, ndërtimi i paautorizuar i objekteve, hedhja e mbeturinave, si dhe eksploatimi i minierave.

Në nxjerrjen e vendimit të atillë, vetëqeverisja lokale ka dëshmuar së dëshiron të vendos raporte gjegjëse ndaj natyrës, me qëllim të ruajtjes së mjedisit jetësor dhe se pengimi i rrezikimit të identitetit natyror i këtij rajoni bëhet çështje e pashmangshme në punën e tyre. Në atë mënyrë kontribuon për realizimin e njërës prej kushteve themelore për turizëm të qëndrueshëm, d.m.th. ndikimin minimal në degradimin e mjedisit jetësorë.

Komuna e Pejës

Dokumenti më i rëndësishëm që shërben si strategji për proceset zhvillimore në komunën e Pejës është Plani zhvillimor komunal 2006-2025.¹¹ Në këtë dokument, sektori i turizmit dhe sektori i bujqësisë paraqiten si dy bartësit kryesorë të zhvillimit, ku dhe projektet e zhvillimit infrastrukturor janë të orientuara drejtë zhvillimit të turizmit dhe bujqësisë, që do të thotë edhe ndikim në zhvillimin e agroturizmit. Përveç kësaj, komuna e Pejës, në vitin 2013 e ka hartuar Strategjinë e zhvillimit ekonomik 2013 – 2017, e cila është e orientuar drejtë ndikimit për zhvillim të qëndrueshëm e që do të jetë në të mirën e banorëve lokalë, zhvillimit të ekonomisë lokale dhe rritjes së punësimit. Në këtë Strategji vihen në fokus ruajtja e mjedisit. Rrjedhimisht, komuna e Pejës është shpallur “Komunë model e brezit të gjelbër evropian”

¹¹ Municipal Development Plan Pejë/Peć 2006-2025, 2006 November, i qasshëm në: <https://bit.ly/2GtG9oL>

(Model municipality of the European Green Belt).¹² Po ashtu, në dokumentet strategjike për zhvillim të turizmit hyn edhe Strategjia e zhvillimit lokal 2014-2020.¹³

Duke parë se turizmi çdo ditë e më tepër orientohet në destinacione të reja, për regjionin e Kosovës perëndimore janë hartuar Strategjia rajonale për zhvillimin e turizmit si dhe Plani i zbatimit të kësaj Strategjie.¹⁴ Kjo Strategji i përfshinë planet zhvillimore për 6 komuna duke krijuar sinergji mes tyre në mënyrë që të arrihet oferta unike e përbashkët dhe atraktive. Strategjia dhe Plani i theksuar janë hartuar nga Agjencia Rajonale për Zhvillim Perëndim, e cila është pjesë e Asociacionit Regjional të Agjencive Zhvillimore në Kosovë (ARAZH), e themeluar për koordinim dhe promovim të zhvillimit rajonal dhe rural në 5 rajonet ekonomike (verior, jugor, lindor, perëndimor dhe ai qendror).¹⁵

Krahas kësaj, në bashkëpunim me BE-në është hartuar Plani rajonal i trashëgimisë për Kosovën Perëndimore 2012-2015¹⁶, i cili në fokusin e vet ka ngritjen e vetëdijes, arsimimin, trajnimet dhe propozimin e aktiviteteve lidhur me trashëgiminë natyrore. Ky dokument i përfshinë edhe çështjet që kanë të bëjnë me ruajtjen e lokaliteteve, restaurimet, informatat mbi trashëgiminë dhe sigurimin e lokacioneve, por e promovon edhe procesin e partneritetit dhe të bashkëpunimit ku përfshihen entitetet qendrore, lokale dhe ato kulturore e turistike, si palë relevante në rajon. Edhe pse është e paraparë për një periudhë të shkurtër kohore, ky Plan edhe më tej u shërben komunave për planifikimin e tyre strategjike në nivelin rajonal. Disa nga planet dhe strategjitë ekzistuese, si dhe hulumtimet në komunën e Pejës, janë realizuar në bashkëpunim me organizatën: “Swiss Contact” e cila kishte rol të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në këtë komunë. Në mesin e tyre janë: “Turizmi në Kosovën Perëndimore – raport mbi strategjinë e tregut”, pastaj “Zhvillimi i produkteve turistike” etj.

Sa i përket bashkëpunimit tejkuftar, komuna e Pejës ka memorandum bashkëpunimi me komunitat Plavë dhe Shkodër për projektin e përbashkët zhvillimor “Majat e Ballkanit”. Gjithashtu duhet theksuar se Peja në vitin 2013 ishte në vendin e parë si destinim për ardhmërinë e turizmit në kuadër të garave “Destinimi më i mirë për arritjen në turizëm - turizmi për të nesërmen” që e ka organizuar Këshilli botëror për udhëtime dhe turizëm. Promovimi të cilin në atë mënyrë e ka realizuar KBBUT (WTTC) në nivelin ndërkombëtar kishte rëndësi të jashtëzakonshme për Pejën si destinim turistik.

Bashkëpunimi mes komunave Pejë dhe Zubin Potok

Në kuadër të projektit rajonal “Bjeshka e Mokrës – perlë e pazbuluar në shtegun Via Dinarica”, të cilin e ka realizuar InTER në bashkëpunim me komunën e Tutinit, Agjencinë Regjionale Zhvillimore të Sanxhakut (SEDA), OJQ-në “Merimangat” nga Peja dhe klubin e

¹² European Green Belt, i qasshëm në: <https://bit.ly/36xukbu>

¹³ Strategjia e zhvillimit lokal 2014-2020, Komuna e Pejës dhe GLV Agroturizmi, 2014 Pejë, i qasshëm në: <https://bit.ly/2O0t3Dx>

¹⁴ Strategjia lokale e turizmit 2016-2020, ARDA, i qasshëm në: <https://bit.ly/2uHZAAm>

¹⁵ Association of Regional Development Agencies (ARDA), i qasshëm në: <https://bit.ly/2tOuE8G>

¹⁶ Regional Heritage Plan for Kosovo* West (2012-2015), 2012 September, i qasshëm në: <https://bit.ly/2Rw2yrA>

bjeshkatarëve “Ahmica” nga Rozhaja, bashkëpunimi mes Pejës dhe Zubin Potokut, formalisht është aprovuar në vitin 2019. Njëri nga rezultatet e këtij projekti ishte edhe nënshkrimi i Memorandumit për bashkëpunim në mes të komunave pjesëmarrëse të këtij projekti. Pra me nënshkrimin e këtij dokumenti komunat Pejë dhe Zubin Potok, në këtë mënyrë i kanë vënë themelet edhe formalisht për bashkëpunim në zhvillimin e turizmit.

Krahas vendosjes së bashkëpunimit në nivelin e vetëqeverisjes lokale, bashkëpunimi i subjekteve të këtyre komunave nga aspekti i zhvillimit të turizmit ka filluar edhe para këtij projekti rajonal. InTER – i dhe OJQ “Merimangat” nga Peja, veç disa vite bashkëpunojnë me shumë sukses në realizimin e aktiviteteve të ndryshme nga fusha e turizmit. Pasi që të dy organizatat punojnë në produktet e ngjashme turistike, siç është sistemi i ngjitjes Via Ferrata, që nga viti 2015, janë organizuar disa projekte të përbashkëta, p.sh. gjatë vitit 2016 është organizuar kampi i ngjitjes “Berim”, ndërsa në janar të vitit 2017 është organizuar programi i përbashkët për trajnimin e udhëheqësve (guidave) në shtegun Via Ferrata dhe shërbimit të shpëtimit.

Përveç kësaj, InTER – i në kuadër të iniciativës për zhvillimin e turizmit “Outdoor In” i organizon ofertat turistike (paketat), të cilat përveç vizitës në Kollashinin e Ibrit e përfshinë edhe vizitën në rajonin e Pejës dhe ngjitjen në Via Ferrata që është e instaluar në këtë rajon. InTER – i dhe OJQ “Marimangat” bashkërisht e zhvillojnë projektin “Turizëm i qëndrueshëm në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm”, në kuadër të të cilit ka dalë kjo analizë, gjë që e vërteton vazhdimësinë dhe bashkëpunimin e mirë të komunave Pejë dhe Zubin Potok nga aspekti i kontributit në zhvillimin e turizmit.

TURIZMI NË KOMUNËN E ZUBIN POTOKUT

Karakteristikat themelore gjeografike

Komuna e Zubin Potokut, e njohur edhe si Kollashini i Ibrit, gjendet në pjesën veriperëndimore të Kosovës dhe ka sipërfaqe prej 333 km². Në përbërje të kësaj komune hyjnë 63 fshatra dhe lagje, dhe sipas informatave të disponueshme llogaritet se i ka 15.200 banorë.

Pozita gjeografike, relievi, klima, hidrografia, flora dhe fauna janë pasuritë më të vlefshme natyrore të komunës së Zubin Potokut e që njëkohësisht janë edhe kushte ideale për zhvillimin e turizmit.

Pozita gjeografike

Kufijtë e komunës së Zubin Potokut, kryesisht janë natyralë – gjeomorfologjik. Zubin Potoku shtrihet në luginën e lumit Ibër, ku tash një pjesë e madhe e saj mbulohet nga liqeni artificial i Ujmanit, që nga fshati Ribariq në veriperëndim deri te fshati Zupç në juglindje. Kufizohet me komunat e Republikës së Serbisë, Tutinin në perëndim dhe me Novi Pazarin në veri, ndërsa kufi administrativ me Zveçanin dhe Mitrovicën në lindje, si dhe me komunat Skenderaj dhe Istog në jug.

Komunën e karakterizon pozita e mirë gjeografike në magjistralen kryesore E-65 Prishtinë - Mitrovicë-Podgoricë-Novu Pazar. Zubin Potoku është 60 km larg nga Prishtina, 20 km nga Mitrovica dhe 55 km nga Novi Pazari. Përveç rrugëve të tjera, për zhvillimin e turizmit në këtë komunë e rëndësishme është edhe rruga rajonale Zubin Potok - Istog.

Relievi

Relievi i Zubin Potokut përbëhet nga tri pjesë të kombinuara, që e përbëjnë fizionominë e rajonit: relievi kodrinor-malor nga bjeshkët Rogozinë dhe Mokra, ku në mes tyre gjendet lugina e lumit Ibër, e formuar nën ndikimin e fuqishëm eroziv të Ibrit dhe lumenjve të tjerë.

Lëvizjet e hershme tektonike e kanë definuar kahun e formimit të luginës. Forca erozive e Ibrit dhe ujëmbledhësit të tij në jug: Përroi i Kovaçit, Oklaçka, Bërnjaku, Çeçeva dhe Përroi i Zi. Në veri Lluçka dhe Përroi i Qengjave të formuara nga zgjerimet erozive, veçanërisht në ato vende ku në lumin Ibër derdhen përrenjtë nga të dyja anët. Përmbi të gjithë këta përrenj dhe lumenjtë kanë vendosur komunikime të shkurtra natyrore në mes të fshatrave malore në lartësi të mëdha mbidetare dhe lagjeve të qyteteve në komunat fqinjë: Istog, Pejë, Skenderaj, Novi Pazar dhe Tutin.

Përrenjtë e shpejtë dhe lumenjtë malorë kanë gdhendur lugina të thella, kanë shpërbërë sipërfaqe të vogla dhe në grykëderdhje kanë krijuar rrafshina aluviale. Mes luginash janë shpatinat në anët e të cilave ndodhen rrafshina të vogla dhe pjerrësira të vogla ose më të mëdha, si rrjedhojë e territorit ku ndodhën.

Klima

Komuna e Zubin Potokut nuk e ka faqen në internet për përcjelljen e rregullt të lëvizjeve klimaterike dhe se kjo mangësi, deri diku mund të kompensohet me vështrim të kujdesshëm në terren. Është i dukshëm dallimi klimaterik në disa pjesë të komunës. Dallimi është për shkak të lartësive të ndryshme mbidetare, ekspozimit, këndit topografik të pjerrësisë së sipërfaqes, struherës nga erërat dhe faktorëve të tjerë.

Marrë në përgjithësi, klima në Zubin Potok është e qëndrueshme kontinentale. Stinët e vitit, relativisht janë të radhitura ngjashëm. Muajt më të ngrohët janë korriku dhe gushti, ndërsa muaji më i ftohtë është janari, gjë që prezantojnë rrethana të volitshme për zhvillimin e turizmit, duke pasur parasysh se potencialet kryesore natyrore të turizmit janë liqeni i Ujmanit dhe bjeshka e Mokrës.

Hidrografia

Bazën hidrologjike të komunës së Zubin Potokut e përbënë lumi Ibër me ujëmbledhësin e vet. Ibri buron nga burimi shumë i fortë në shkëmbin gëlqerorë në bjeshkën e Hajlës, në lartësinë prej 1360 m, në mes të majave Dramodol dhe kodrës së Smilenicës. Gjatësia e tërësishme e Lumit Ibër është 272, 25 km, me ujëmbledhësin prej 80.59 km² dhe me nivelin mesatar vjetor të ujërave prej 755 mm. Nëpër Zubin Potok, Ibri kalon në gjatësi prej 43 km, prej të cilave 24 km janë në Liqenin artificial të Ujmanit, ndërsa 2 km në liqenin kompenzacional të Pridvorit.

Lumi Ibër është “zbutur” me ndërtimin e pendës së “Ujmanit” në vitin 1979, e cila ka lartësi prej 107,5 m, dhe gjatësi prej 520 m. Liqeni i Ujmanit gjendet në grykën e lumit Ibër, në kilometrin e 20 në Zubin Potokun qendror. Gryka e Ibrit është e pyllëzuar mirë që do të thotë zonë e mbrojtur e pranueshme sepse përbëhet nga brezi pyjor. Në pjesën e epërme të liqenit është një sipërfaqe e vogël e pa pyllëzuar, gjegjësisht livadh dhe kullosë, që është pjesë e sipërfaqes së tarracës aluviale. Kjo pjesë është e qasshme, ka cekëtina dhe është e përshtatshme për shfrytëzimin e ujit për qëllime rekreative. Biotreguesit e liqenit tregojnë se uji është i pastër. Në liqe ka biomasë të madhe të peshkut. Liqeni me bukurinë e tij i mahnit që të gjithë dhe për këtë shkak është vendi kryesor turistik gjatë muajve të verës për shumë vizitorë nga rrethina, por edhe i tërë regjioni.

Flora dhe fauna

Klima e butë kontinentale, e cila në lartësitë e mëdha mbidetare kalon në klimë lokale kontinentale, respektivisht klimë malore, e pasur me rrjedha ujore dhe burime, mjaft e pyllëzuar, me kullosa të pafundme dhe mjedis të pastër e të shëndoshë jetësor, ka ndikuar në popullimin e këtij rajoni me bimë dhe kafshë të shumëllojshme.

Pyjet, edhe pse mjaft të prera ilegalisht në vitet e fundit, e mbulojnë 2/3 të sipërfaqes së përgjithshme të komunës së Zubin Potokut. Pyjet shpesh herë janë të përziera me kullosat dhe arat, por ekzistojnë edhe pjesë ku mbulimi nga pyjet është thuajse i pandërprerë, siç është rrëzë bjeshkës së Mokrës. Bungu dhe ahu janë llojet më të përhapura të drunjve, por krahas tyre gjendet edhe shkoza, frashri, mështekna etj. Në lartësinë mbidetare mbi 1500 m rriten edhe lloje të shumta të halorëve. Shumëllojshmëria e vegjetacionit pasurohet edhe nga numri i shumë bimëve mjekuese dhe luleve të malit. Lule e veçantë me të cilën krenohet ky rajon është lulja endemike *ramonda* që rritet në bjeshkën e Mokrës dhe në grykën e Përroit të Zi.

Kur bëhet fjalë për shumëllojshmërinë e botës shtazore, në bjeshkën e Mokrës ka një numër të madh të shtazëve të egra të gjahut, që është potencial i rëndësishëm për zhvillimin e këtij lloji të turizmit. Këtu janë të pranishme thuaja të gjitha llojet e gjallesave që janë tipike për regjionin e gjerë, që nga zogjtë e kënetave: pata e egër, gata e përhime, xhufka, shytëza, karabullaku i ujit dhe viteve të fundit paraqitet edhe një tufë e mjellmave të bardha. Nga familja e shqiponjave takohen gjeraqina, skifteri, shqiponja kryqëzore, llojet e hutinëve etj. Kurse nga familja e pulave janë: shkurtëza, thëllëza, pula e egër dhe gjeli i egër, që është njëherë edhe krenaria e terrenit të gjahut. Nga gjitarët janë prezent kafshët, siç janë: ketri, bukla, qelbësi, kunadhja e artë, kunadhja e bardhë, macja e egër dhe dhelpra. Nga egërsirat e imta, më i përfaqësuar numerikisht është lepuri, ndërsa nga egërsirat e mëdha më të përfaqësuarat numerikisht janë: sorkadhet, deri i egër, ujku dhe ariu. Duke marrë parasysh se numri i arinjve në dekadat e fundit është zvogëluar në tërë Evropën, ashtu edhe te ne, duhet theksuar se ariu i murrme mund të takohet në bjeshkën e Mokrës e që është kafsha e egër më trupmadhe në Evropë, si dhe grabitçari më i madh që e arrin lartësinë prej 100 – 120 cm, gjatësinë prej 200 deri 250 cm, si dhe peshën prej 180 deri 300 kg.

Iniciativa për zhvillimin e turizmit në Zubin Potok - Outdoor In

Edhe pse turizmi ishte pjesë integrale e dokumenteve strategjike të komunës së Zubin Potokut, në zhvillimin e turizmit nuk është punuar aq deri në vitin 2013. Me ndihmën financiare të Unionit Evropian në Kosovë, InTER –i në vitin 2013 e ka iniciuar projektin Outdoor In me qëllim që të shfrytëzohet potenciali natyror i këtij rajoni për zhvillimin e

sektorit të turizmit në komunën e Zubin Potokut përmes avancimit të infrastrukturës turistike, përmes rritjes së kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve dhe promovimin e potencialit turistik për qëllim të fillimit të aktiviteteve që krijojnë turizëm. Projekti u realizua në bashkëpunim me komunën e Zubin Potokut, projekti ka përfunduar suksesshëm në vitin 2015. Pastaj ka filluar sendërtimi i atij suksesi edhe përmes të llojeve të ndryshme të përkrahjes për zhvillimin e turizmit.

Për deri sa qëllimi i përgjithshëm i iniciativës ishte që të zhvillohet infrastruktura turistike, rezultatet konkrete kanë sjellë ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis, veçanërisht në aspektin e përplotësimit të komponentit social të zhvillimit të qëndrueshëm. P.sh., në liqenin e Ujmanit janë ndërtuar plazhi dhe terreni i lojës për fëmijë, si dhe muri i destinuar për ngjitje të lirë, ndërsa shtigjet e shumta për shëtitje dhe çiklizëm janë shënuar veçanërisht dhe i përfshinë edhe vendet për pushim. Sot me ato atraksione mund të kënaqen banorët lokal por edhe që të gjithë vizitorët dhe se në këtë kontekst janë zhvilluar edhe produktet turistike që i kontribuojnë interakcionit më të madh në vetë bashkësinë, por edhe interakcionit të komunitetit lokal me vizitorët. Në favor të kësaj fletë fakti se në kuadër të kësaj iniciative, komuna e Zubin Potokut përveç tjerash, ishte nikoqire e dy kampeve verore ndërkombëtare dhe garave regjionale të sporteve ekstreme si dhe shëtitjeve nëpër natyrë gjatë viteve 2013 – 2014. Në këtë mënyrë, përveç përfshirjes së të rinjve dhe komunitetit lokal në zhvillimin e turizmit, është shfrytëzuar rasti që kjo pjesë e Kosovës të promovohet edhe si destinim kryesor për turizëm aventuresk.

Krahasuar me periudhën para fillimit të kësaj iniciative Outdoor In, aktualisht në komunën e Zubin Potokut ekziston strategjia për zhvillimin e turizmit dhe është vendosur rrjeti i ofruesit të shërbimeve në fushën e turizmit, ashtu që gjëra të ndërlidhen në përkrahjen fillestare dhe t'i kontribuojnë zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në këtë rajon. Outdoor In, që nga fillimi gjer më sot, ka vazhduar që aktivisht ta promovojë këtë rajon përmes faqeve të internetit dhe rrjeteve sociale, si destinim për turizëm aktiv.

Me realizimin e nevojave lokale në këtë pjesë të Kosovës, përmes kësaj iniciative janë shtuar shanset që të rinjtë të kyçen në aktivitete në vend të hapur, ta stimulojnë komunikimin ndëretnik mes njerëzish që jetojnë këtu si dhe të krijohet pasqyrë pozitive për Zubin Potokun. Duke vepruar kështu, përkrahet edhe zhvillimi ekonomik lokal e që gjithashtu kontribuon edhe në punën për mbrojtjen e mjedisit duke dhënë stimulim shtesë për realizimin e projekteve të ndryshme të zhvillimit në fushën e turizmit.

Potencialet turistike dhe produktet

Pjesa e bjeshkës së Mokrës – Bukuroshes së Ballkanit, siç e ka quajtur dikur gjeografi Jovan Cvijiq, me vlerat karakteristike turistike dhe veçoritë, siç është liqeni i Ujmanit, i krijuar artificialisht me pendën në Ibër, janë motivet më të rëndësishme dhe më të njohura të bukurive turistike dhe pasqyrës së këtij rajoni.

Vlera dhe karakteristika e veçantë rekreative-turistike e këtij rajoni është mjedisi i qetë, pejzazhi dhe forma dekorative estetike e përmbushur me bimët dhe kafshët e rralla. Për këtë shkak, gjatë verës ky rajon është jashtëzakonisht i përshtatshëm për shëtitje rekreative dhe bjeshkatari, ndërsa gjatë dimrit i përshtatshëm për bjeshkatarë dhe gjahtarë të devotshëm.

Në harmoni me vlerat dhe karakteristikat rekreative-klimatike të motiveve themelore turistike dhe zhvillimit të gjertanishëm të turizmit, në komunën e Zubin Potokut mund të konstatohen këto forma ose lloje të turizmit që mund të bëhen të kërkuara në tregun e turizmit, varësisht nga ekzistimi i kushteve dhe mundësive materiale dhe organizative. Në Zubin Potok veç janë definuar disa lloje të turizmit në potencialet më të mëdha natyrore për zhvillimin e turizmit, ndërsa disa duhen pritur që të zhvillohen në vazhdim. Më i përfaqësuar është zhvillimi i turizmit në bjeshkën e Mokrës dhe në liqenin e Ujmanit, por gjithashtu duhen cekur edhe turizmi në ujë, turizmi i gjahut, turizmi transit si dhe turizmi kulturor-historik.

Në kuadër të turizmit aktiv më të përfaqësuarit janë ecja në bjeshkë, çiklizmi dhe çiklizmi malor, lëshimi me kanu, paraglajdingu, gjahu, peshkimi, si dhe produkti atraktiv turistik Via Ferrata Berim.

Via Ferrata Berim

Via Ferrata Berim është produkti më i avancuar dhe atraktiv në Zubin Potok. Vetë emri Via Ferrata rrjedh nga italishtja që do të thotë “Rrugë e çeliktë”. Ferrata është e vendosur në shkëmbinjtë e Berimit në bjeshkën e Mokrës, 25 km nga Zubin Potoku, ndërsa rruga për në Via Ferrata kalon nëpër pendën e Ujmanit dhe nëpër fshatin Kovaçe, pastaj rruga e shtruar me gurë shkon deri në Previe dhe vazhdon deri në rrëzat e Berimit, ku fillon edhe Via Ferrata.

Ky atraksion turistik është bërë ashtu që shkëmbinjtë, të cilët në shikim të parë duken të paqasshëm, mund të kalohen edhe nga të gjithë të interesuarit e jo vetëm nga ata që kanë përvojë në ngjitje malore. Me pak vullnet të mirë, shpirt aventurier dhe përgatitje minimale fizike mjafton që të kalohet shtegu prej 4 km në shkëmbinjtë e Berimit. Ecja në sipërfaqe horizontale, lëvizja në sipërfaqe të rrëpishme, nëpër shpella, nëpër urën e varur me gjatësi prej 24 m, pastaj litari i çeliktë prej 9 m, janë atraksione që Via Ferratan e bëjnë të veçantë e që aktualisht është Via Ferrata më e gjatë në rajon.

Via Ferrata fillon me shtegun malor në kampin logjistik, kalon poshtë shkëmbinjve të Berimit dhe ndahet me shtegun e ngushtë deri te sektori i parë vertikal. Sektori i parë vertikal ka gjatësi prej 80 m dhe çon deri te shpella ku është e vendosur ulësja mu në tehun e sektorit vertikal, me shikim mahnitës në peizazhin rrethues. Via Ferrata pastaj vazhdon me ngritje vertikale përmes shpellës deri te maja e parë e Berimit në lartësi prej 160 m nga pika fillestare. Kjo pikë është dalja e parë për në kampin e logjistikës. Via Ferrata vazhdon më tej deri te maja e dytë e Berimit me sektorin tjetër vertikal. Kjo pjesë e Via Ferrata e përfshin

edhe pjesën horizontale që ofron përvojë plotësisht tjetër nga ngjitja në sektorët paraprakë vertikal. Maja tjetër është në lartësi mbidetare prej 1520 m ose lartësi relative nga pika fillestare prej 300 m. Aty ndodhet vendpushimi shumë i përshtatshëm për të fotografuar peizazhe mbresëlënëse të Kollashinit të Ibrit, Rogozinës dhe Kopaonikut, por shihet edhe një panoramë e vogël e liqenit të Ujmanit. Aty gjendet edhe dalja e dytë nga Via Ferrata dhe shtegu vazhdon teposhtë pjerrësirës shumë të thepisur deri te kampi logjistik.

Via Ferrata vazhdon edhe më tej deri te majat e fundit 3 dhe 4 në Berim, ku përfundon edhe ky atraksion turistik. Ngjitja deri në majën e dytë vazhdohet vertikalisht, por me numër të vogël të kalimeve të krijuara artificialisht ku kjo ngjitje kërkon mundim më të madh, si dhe kujdes të shtuar me aktivizim të të gjitha shqisave. Në këtë pjesë të Via Ferrata duhen shfrytëzuar vendkalimet dhe mundësit për tu mbajtur me dorë në gurë më tepër se sa në dy pjesët paraprake të saj. Pasi që vazhdohet ngjitja, për ngjitësit hapen panorama të reja dhe se shikimi shkon deri në bjeshkët e Kelmendit dhe të Kopaonikut, Ndërsa liqeni i Ujmanit zbulohet në tërësi me bukuritë mahnitëse dhe ngjyrat mbresëlënëse që të përvetësojnë nga majat e Berimit. Ky segment përfundon me ecjen nëpër kreshtë, nëpër të cilën arrihet të maja e tretë nga hapet shikimi në dy ura varëse mbi humnerën që paraqesin atraksion të vërtetë të kësaj rruge të çeliktë. Ura i pret ata që ngjiten në vazhdim për drejtë majës së Berimit dhe në fund të Via Ferrata. Ura e parë ka gjatësi prej 27 metrash dhe në të janë të vendosura 57 dërrasa për të shkelur të cilat duhen kaluar për të arritur te ura e dytë që është “ecje në trapez” më gjatësi prej 9 metrash. Pas këtyre sfidave Via Ferrata shkon krahas kreshtave deri ke kreshta e fundit, e cila është vertikale, ku dhe përfundon ky atraksion turistik. Në fund mbetet që ta ndjejmë kënaqësinë e panoramës fantastike nga lartësia prej 1733 m e majës së Berimit. Zbritja është shteg malor i shënuar.

Duke ju falënderuar angazhimeve të mëdha për promovimin Via Ferrata –Berim, e njëjta u bë produkt i njohur turistik i kësaj ane që kishte përfaqësimin më të madh si në mediat vendore, ashtu edhe në ato ndërkombëtare që e promovojnë turizmin.. Magazina i njohur botëror *Lonely Planet* këtë Via Ferrata e ka karakterizuar si mbresëlënëse, duke i kushtuar vëmendje jashtëzakonisht të madhe në udhëzimet e saj turistike për Ballkanin Perëndimor. Por, edhe mediat tjera nga e tërë bota shkruajnë për këtë atraksion turistik në Kollashinin e Ibrit, duke i ftuar lexuesit e tyre që të njëjtën ta radhisin në kalendarët e tyre të vizitave si destinacion që duhet parë. Gjatë katër viteve të kaluara këtë Via Ferrata në Berim e kanë vizituar rreth 1200 turistë nga regjioni dhe bota, gjë që ka domethënie shtesë për atraksionin e saj.

Alpinizmi

Në pjesën e bjeshkës së Mokrës që i takon komunës së Zubin Potokut ekzistojnë mbi 100 km. shtigje të shënuara malore. Shtigjet janë të kategorive të ndryshme dhe u janë përshtatur tipave të ndryshme të alpinizmit.

Kjo fushë mund të jetë interesante edhe për profesionistët e këtij sporti, por edhe për amatoret. Numri i madh i alpinistëve kanë motive të ndryshme, e që kryesisht janë sfidat,

kënaqësia në natyrën e virgjër dhe shoqërimi. Alpinizmi është sport i cili qëllimin e vet kryesor e ka ngjitjen në majën e bjeshkës, e që kur është në pyetje bjeshka e Mokrës më majat e Berimit në lartësi prej 1733m shtrihet shikimi në liqenin e Ujmanit, në Kopaonik dhe Rogoznë nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër shtrihet shikimi në Dukagjin dhe bjeshkët e Kelmendit.

Çiklizmi dhe çiklizmi malor

Liqeni i Ujmanit dhe bjeshkët përreth janë parajsë e vërtetë për çiklizmin malor. Kollashini i Ibrit i ofron që të gjitha, duke filluar nga shtigjet e lehta rreth liqenit dhe fshatrave përreth deri të shtigjet më të mundimshme në shpatinat e bjeshkës së Mokrës, që janë të njohura për numrin e shumë të burimeve dhe liqeneve të bjeshkës, si dhe për peizazhet me livadhe të gjata dhe pyjet më gjelbërim të përhershëm. Bukuria e Kollashinit të Ibrit mund të përjetohet dhe përmes 120 km shtigjesh të çiklisteve me vështirësi të ndryshme, ndërsa çiklistet mund t'i kombinojnë ato ashtu që t'i kalojnë në mënyrën më të përshtatshme sipas aftësive dhe dëshirave vetanake.

Kanuizmi

Zubin Potoku është “shtëpia” e liqenit të Ujmanit, njërit prej liqeneve më të mëdha në rajon i cili ofron kushte të shkëlqyeshme të kanuizmit në liqenin e hapur apo në ndonjërin nga kanalet e shumta në fillim apo në fund të liqenit. Kanuizmi mund të kombinohet edhe me aktivitete të tjera siç janë notimi gjatë verës apo peshkimi gjatë tërë vitit. Aktualisht në ofertën turistike janë 3 kanu që mund të huazohen gjatë tërë vitit.

Gjahu dhe peshkimi

Gjahu sot është rekreacion, atraksion dhe pasion. Dikur gjahu ka shërbyer për mbijetesë, ndërsa sot për argëtim dhe kënaqësi në kohën e lirë. Bjeshka e Mokrës me shpatijet e veta është kryesisht habitat i kafshëve të egra dhe vendtakim i gjuetarëve. Siç është theksuar edhe më lartë në këtë punim, në territorin e bjeshkës së Mokrës gjenden edhe llojet të rralla të kafshëve të egra siç janë: ariu dhe gjeli i egër.

Turizmi i gjahut, sipas këtyre kushteve natyrore do të ketë perspektiv, dhe mund të bëhet veprimtari shumë rentabile ekonomike-turistike nëse më masa mbrojtëse dhe ripërtëritjen e popullacionit të kafshëve të egra përmirësohet kapaciteti terrenit të gjahut dhe bëhet përgatitja për mbarështimin e ndonjë lloji të kafshëve të egër në hapësira të kufizuara të terrenit të gjahut. Më këtë kushte gjahu do të merrte karakteristikat e turizmit ndërkombëtarë të gjahut. Pasi që është njohuri e përgjithshme së gjahut është njëri prej sporteve më të kushtueshme dhe se adhuruesit nga tërë bota me kënaqësi i vizitojnë destinacionet atraktive, mund të kërkohet shansi për më tepër investime në zhvillimin e turizmit të gjahut. Aktualisht, gjahu në këtë rajon është i lejuar vetëm në bazë të rregullave dhe dispozitave të definuara qartë dhe vetëm

në periudhën e caktuar vjetore. Për përcjelljen e aktivitetit të gjahut është ngarkuar shoqata e gjahtarëve Berim – Zubin Potok, si njëra ndër shoqatat më të vjetra në këto hapësira.

Një nga destinacionet më të përshtatshme për peshkatarët gjithsesi është liqeni i Ujmanit, i pasur me peshk, i qetë dhe mjaft i madh që ti gostisë të gjithë peshkatarët e interesuar si ata profesionalë, ashtu edhe peshkatarët që dalin për rekreacion. Gjatë tërë vitit liqenin e vizitojnë peshkatarët dhe jo rrallë ndodhë që peshqit të jenë aq të mëdhenj sa ka vështirësi të nxjerrin nga uji si p.sh. krap prej 25 kg dhe llojet të tjera të peshqve më të vegjël. Edhe lumi Ibër është i pasur më peshq, por ekziston edhe hurdha e peshqve që punon gjatë tërë vitit e që është e vendosur jo larg pendës së liqenit të Ujmanit, tek e cila thjesht arrihet përmes rrugës magjistrale.

Ndjekja e trendeve dhe nevojave të turistëve

Pasi që njëra prej veprimtarive themelore të InTER-it është zhvillimi i turizmit në Zubin Potok, gjegjësisht në Kollashinin e Ibrit, që nga viti 2015, përmes pyetësorëve on-line përcjellën preferencat e turistëve dhe në harmoni me to definoheh hapat e ardhshëm për zhvillimin e turizmit. Pyetësi është i destinuar për vizitorët dhe turistët potencialë të këtij rajoni, të cilët në këtë mënyrë e kanë mundësinë që t'i shprehin preferencat e tyre për llojet e ndryshme të aktiviteteve turistike. Përmes këtyre pyetësorëve synohet të konstatohet profili i turistëve të cilët Kollashinin e Ibrit e shohin si destinim atraktiv turistik dhe konstatohen motivimet e tyre për ta vizituar këtë anë, si dhe aktivitetet më të cilat ata dëshirojnë të merren gjatë qëndrimit këtu, por njëkohësisht edhe mjetet financiare që planifikojnë t'i shpenzojnë gjatë qëndrimit. Përmes hulumtimit të këtyre nevojave të turistëve potencialë jepet kontribut edhe për përparimin e ofertave turistike, si dhe për ofrimin e produkteve të reja turistike.

Në bazë të të dhënave të mbledhura përmes pyetësorit të realizuar në vitin 2019 dhe krahasimit të tyre me të dhënat e viteve paraprake, është e mundur që të identifikohen ndryshimet e caktuara në raport me turistët ndaj këtij destinimi dhe nevojave të tyre.

Vizitorët dhe turistët potencialë që kanë marr pjesë në mbledhjen e të dhënave e që kanë shpreh interesim të madh për ta vizituar Kollashinin e Ibrit, i cili është gjithnjë në rritje. Kur është fjala për profilin e vizitorëve potencialë është e dukshme se ka ndryshuar fokusi i grupmohave, ashtu që shënon rritje interesimi për ofertat turistike në Kollashinin e Ibrit tek grupmoshat mes të 30-39 vjet.

Sipas analizës së të dhënave të mbledhura nga vitet paraprake u dëshmuua se vizitorët në Kollashinin e Ibrit vijnë për shkaqe të ndryshme. Të dhënat e fundit tregojnë se arsyeja më e shpeshtë e vizitës është turizmi. Turizmi si qellim i vizitës shënon rritje prej 50 në 70 %, e që është tregues i rëndësishëm i cilësisë dhe atraksioneve të ofertës turistike ekzistuese.

Duke marr parasysh burimet natyrore që janë në funksion të zhvillimit të turizmit, pranvera dhe vera janë periudhat vjetore kur turistët më së shumti vendosen për të qëndruar në Kollashinin e Ibrit. Turistët vijnë nga vendet e ndryshme të regjionit dhe ka edhe turistë vendorë. Në shumicën e rasteve vijnë me transportin vetanak, por vitin e kaluar shënohet rritje relative e interesimit për llojin e transportit të organizuar. Ky trend nuk i ik faktit se numri më i madh i vizitorëve janë grupe miqsh.

Në mesin e vizitorëve të interesuar më së shumti ka të atillë që qëndrimin e tyre e bazojnë në bujtje në mjedisin natyror, siç janë shtëpitë e vikendit dhe bungallovët në tregun e liqenit. Edhe pse ky trend shkon në të njëjtin drejtim prej kur përcillen nevojat e turistëve edhe më tej, me gjithë atë ekziston mungesa e kapaciteteve të akomodimit të këtij lloji. Ky problem fiton në rëndësi nëse theksohet fakti se vit pas viti ka rritje të dukshme të mjeteve financiare të planifikuara që turistët janë të gatshëm t'i shpenzojnë për një akomodim të dëshiruar. Sa për krahasim, gjatë vitit 2017-2018 vetëm 19% të vizitorëve kanë qenë të gatshëm që për akomodim në Kollashinin e Ibrit të shpenzoj prej 6-10 €, ndërsa të dhënat e fundit tregojnë së ajo përqindje është rritur në 41 %.

Si aktiviteti më atraktiv në ofertën turistike, krahas Via Ferrata Berim u ceken alpinizmi, çiklizmi malor, kanuizmi, paragllajdingu, kampimi, raftingu në Ibër, por interesim të shtuar kanë treguar edhe për vizitat e trashëgimisë kulturore e historike dhe objektet e kultit në këtë anë. Duke marrë parasysh se oferta turistike ka avancuar, është në rritje edhe numri i vizitorëve që janë të gatshëm të shpenzojnë më tepër para për produktin e caktuar turistik dhe madje edhe për tërë pakon turistike. Të ky fakt duhet parë mundësia për zhvillimin e ardhshëm të turizmit, i cili në të njëjtën kohë do të kontribuonte zhvillimit ekonomik të këtij rajoni.

Me rastin e mbledhjes së të dhënave të pyetësorëve vizitorët dhe turistët potencialë mjaft shpesh kishin sugjerime konstruktive për zhvillimin e mëtejme dhe punën e turizmit në Kollashinin e Ibrit. Në mesin e atyre sugjerimeve gjithësesi theksohen përshtatja e kapaciteteve të akomodimit me nevojat dhe numrin e turistëve, si dhe avancimi i shërbimeve në objektet e hotelerisë. Kjo mund të thuhet se është vërtetim i nevojave për zhvillim më të fuqishëm të sektorit privat në fushën e turizmit ku përveç tjerash do të ndërtoheshin objektet e reja hoteliere dhe do të rinovoheshin ato ekzistuese. Kur është fjala për ofrimin e shërbimeve, në bazë të sugjerimeve të vizitorëve mund të nxirret përfundim se duhet punë për avancimin e potencialit njerëzor për punën në fushën e turizmit, dhe njëherësh mendohet që bashkësia ose komuniteti lokal ka nevojë për edukim shtesë për ushtrim të suksesshëm të fushës së turizmit. Krahas kësaj, është identifikuar edhe nevoja për përmasimin dhe avancimin e infrastrukturës rrugore, duke marr parasysh se produktet turistike më atraktive janë larg qendrës së Zubin Potokut e që rrjeti rrugor për atje nuk është mjaft i zhvilluar. Sa i përket vetë përmbajtjes së ofertave turistike, analiza e të dhënave tregoi se vizitorëve të kësaj ane pa marr parasysh infrastrukturën ekzistuese sportive u intereson shumë edhe organizimi shtesë i manifestimeve sportive, por edhe kulturore. Si sugjerim “horizontal” shihet rëndësia e mbrojtjes së mjedisit për zhvillimin e turizmit dhe njëjtë ka të bëjë edhe me angazhimet

shtesë që të investohet në atë drejtim, si nga pushteti lokal, po ashtu edhe nga vet banorët dhe të gjithë vizitorët.

Edhe krahas kësaj se vërehen disa të meta dhe mangësi, vizitorët me sugjerime të veta ndihmojnë që të orientohet puna për zhvillimin e turizmit, por edhe duke i përcjell përvojat e veta pozitive i kontribuojnë eliminimit të paragjytimeve për këtë hapësirë, të fituara në bazë të mediave. Në vitet në vazhdim gjithsesi duhet vazhduar me aktivitetet për krijimin e një brendi pozitiv dhe promovimin e Kollashinit të Ibrit si destinim atraktiv për zhvillimin e turizmit

aktiv.

TURIZMI NË KOMUNËN E PEJËS

Turizmi në komunën e Pejës zhvillohet shume gjatë dhe kryesisht është i fokusuar në turizmin malor për shkak të potencialeve dhe të mirave materiale, ndërsa alpinizmi që u zhvillua në këtë hapësirë paraqet nxitje për tërheqjen e grupeve të turistëve. Mu në komunën e Pejës, në vitin 1928, është themeluar Shoqata e parë e Bjeshkatarëve në Kosovë. Në regjionin e Pejës janë prezentë edhe llojet e tjera të turizmit, siç është ai shëndetësor që zhvillohet në potencialet e Banjës së Pejës, turizmi transit, ku Peja për shkak të pozitës së vet gjeografike dhe lidhjeve të mira në mes të Evropës perëndimore dhe asaj lindore është vendqëndrim për shumë vizitorë. Viteve të fundit me shpejtësi zhvillohet turizmi aktiv, ku vizitorëve u ofrohen atraksione të ndryshme unike, siç janë: 3 Via Ferrata, Zip Linja dhe Parku i Aventurave.

Potencialet dhe produktet e turizmit

Vështruar në përgjithësi në bazë të potencialeve turistike ekzistuese, komuna e Pejës ndahet në këto 4 zona turistike: Zona turistike e Rugovës; Zona turistike e Drinit të Bardhë (Radavci); Zona turistike e qytetit të Pejës; dhe Zona turistike e arsimit, sportit dhe turizmit (AST). Veçori e këtyre zonave është se asnjëra nuk mund të funksionoj pa qenë e lidhur me zonën tjetër. Ajo që është jashtëzakonisht e rëndësishme, është se organizimi turistik në komunën e Pejës bazohet në zhvillim të qëndrueshëm dhe se të gjitha zonat janë të lidhura mes vete dhe koordinohen ashtu që sigurohet përkrahja e ndërsjellë, duke nënkuptuar edhe përfshirjen e banorëve lokalë.

Zonat të cilat e kanë potencialin më të madh të zhvillimit të turizmit janë zona e bjeshkëve të Rugovës dhe zona e Drinit të Bardhë (Radavci), sepse dallojnë nga aspekti i potencialeve natyrore dhe nga mundësit për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit. Zona e qytetit ofron mundësi për zhvillimin e turizmit kulturor dhe se është pika e parë me të cilën do të takohen turistët, e që ky potencial kulturor është shumë i rëndësishëm për komunën e Pejës për unifikimin e ofertës turistike, ndërsa zona AST gjithashtu është e rëndësishme sepse planifikohet zhvillimi i projektit “Ski Qendra Borea”, ku do të kyçen sektorët siç është arsimit, sporti dhe zhvillimi i turizmit. Secila nga këto zona disponon me potenciale të ndryshme turistike dhe kanë të zhvilluar produkte të llojllojshme turistike, të cilat janë përshkruar në vazhdim të tekstit.

Zona turistike e Rugovës – gjendet në veriperëndim të Pejës dhe është zona me potencialet më të mëdha natyrore për zhvillimin e turizmit në Pejë. Bukuritë natyrore që gjenden në këtë rajon shtrihen në sipërfaqe prej 32500 ha që janë pjesë e Parkut Nacional Bjeshkët e Nemuna, por njëkohësisht janë edhe pjesa më e bukur e këtij Parku.

Ajo që këtë zonë e bënë më atraktive është afërsia me qytetin e Pejës, sepse në largësi vetëm prej 1 km nga qendra kemi qasje në pjesën e mbrojtur së Grykës së Rugovës. Pra, atraksioni kryesor këtu është Gryka e Rugovës, e cila veçohet si përmendore unike e natyrës jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë, në sipërfaqe prej 4301 ha e mbrojtur me ligj që nga viti 1998.

Gjatësia e Grykës së Rugovës është 13 km, nëpër të cilën rrjedh lumi Bistrica e Pejës, i cili krijohet nga burimet e tjera të ujit në pjesë të ndryshme të Rugovës, ndërsa shkëmbinjtë kolosalë që ngritën përgjatë grykës e arrijnë lartësinë deri në 1000 m. Në ata shkëmbinj mund të shihen ujëvara, shpella dhe florë e pasur. Pjesa më atraktive për rekreacion që njihet me emrin “Bubavci”, ndodhet mu në hyrjen e grykës nga ana jugore. Kjo pjesë është e mbrojtur me ligj si sipërfaqe botanike e që e karakterizojnë reliktet endemike të llojit të luleve *Forsitia ballkanike* (*Forsythia Europea*). Potenciali turistik malor i Pejës shtrihet në 13 fshatra të Rugovës në lartësi mbidetare prej 1000 deri 1800m. Si potenciale të veçanta turistike në këtë zonë mund të theksohen 2 liqene në lartësi 1860m, majat e bjeshkëve siç janë Hajla (2403m) dhe Guri i Bardhë (2522m), shumë shpella, dhe veçanërisht theksohet shpella “Gryka e Madhe” më gjatësi prej 13km. Kjo zonë është karakteristike për shumëllojshmërinë e florës me mbi 1500 lloje të identifikuar dhe faunë të shumtë, siç janë: rrëqebulli, ariu i murrme, dreri, dhia e egër, shqiponja e shkëmbinjve dhe gjeli i egër, gjë që këtë zonë e veçojnë për numrin më të madhe të atraksioneve turistike në Pejë.¹⁷

Zona turistike Drini i Bardhë (Radavci), gjithashtu është shumë atraktive me potencial të madh për zhvillimin e turizmit në komunën e Pejës. Duke pas parasysh vlerat natyrore të kësaj zone, është paraparë që këtu të zhvillohet turizmi ekologjik dhe i fshatit, si lloje që do të ndikojnë në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në komunën e Pejës. Fokusi këtu bie në Ujëvarën e Drinit të Bardhë, më gjatësi prej 30m e që është ujëvare unike në Kosovë që tërheq numër të madh të banorëve vendorë dhe turistëve të huaj. Këtu është edhe burimi i Drinit të Bardhë, njërit prej lumenjve më të mëdhenj të Kosovës. Në këtë zonë është edhe Shpella e Radavcit, e njohur me emrin “Bukuroshja e Fjetur” shpellë që është e hapur për vizita turistike. E tërë kjo zonë ka sipërfaqe prej 89. 94 h. dhe është e mbrojtur me ligj që nga viti 1983.¹⁸

Karakteristikë themelore e kësaj zone është Gryka e Radavcit, të cilën e ka krijuar lumi Drini i Bardhë. Përgjatë kësaj Gryke, banorët lokalë kanë hapë restorante ku ofrohen shërbime të shkëlqyera dhe si specialitet i veçantë, krahas ushqimit tradicional, është trofta që turistët mund ta shijojnë në mjedise magjepsëse në natyrë. Vlerat natyrore të kësaj zone kanë të bëjnë jo vetëm me komunën e Pejës, por edhe më Rozhajën e Malit të Zi, ndërsa lidhshmëria e këtyre potencialeve natyrore ndikon në zhvillimin e turizmit jo vetëm në aspektin lokal, por edhe në aspektin regjional. Produktet turistike në këtë zonë përfshijnë edhe alpinizmin, çiklizmin malor, paragllajdzimin, turizmin e fshatit dhe thesarin kulturorë.

¹⁷ Vlerat e trashëgimisë natyrore të Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, 2005 Prishtinë, i qasshëm në: <https://bit.ly/316VJjt>

¹⁸ Studim - Mbi arsyeshmërinë e shpalljes së territorit të Bjeshkëve të nemuna park nacional, Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor, 2003 Prishtinë, i qasshëm në: <https://bit.ly/2tLnD8B>

Zona e qytetit të Pejës ofron një shteg turistik kulturor që përfshin historinë e pasur të zhvillimit të Pejës që nga koha ilire e deri më sot. Këtu ekziston një trashëgimi e konsiderueshme kulturore dhe historike, nga trashëgimia arkeologjike e periudhës ilire që mund të vizitohet në Muzeun e Pejës, trashëgiminë arkitekturore si dhe shtëpitë e kullat e vjetra karakteristike, kompleksin historik të Mullirit të Haxhi Zekës, pastaj kishave, xhamive dhe teqeve, deri te hamami dhe të tjera. Trashëgimia etnologjike, siç janë zanatet, veshjet tradicionale, folklori, lojërat tradicionale të Rugovës, ushqimi dhe zakonet tradicionale, janë të ekspozuar në Muzeun e Pejës. Kjo zonë karakterizohet me potencialin kulturor i cili është pjesë e ofertës turistike.

Zona AST (Arsimi, Sporti dhe Turizmi) është zonë që i bashkon të tre sektorët - arsimin, sportin dhe turizmin. Zona është planifikuar të zhvillohet në pjesën jugore të Pejës, në rrugën për në Deçan. Potenciali kryesor qëndron në mundësinë e zhvillimit të një vendi për ski “Borea” që do të jetë si qendër turistike gjatë sezonit të dimrit dhe do të ketë teleferikët dhe pistat e skive, ndërsa në sezonin e verës do të përdoret për shëtitje, ecje, çiklizëm malor, ngjitje nëpër shkëmbinj, paraglajding, kalërim, çiklizëm dhe më shumë. Universiteti Publik Haxhi Zeka tani është i integruar në këtë fushë dhe njihet si një potencial i shkëlqyeshëm që do të mundësojë pjesëmarrjen e studentëve në zhvillimin e kësaj qendre. Përveç kësaj, parashihet ndërtimi i stadiumit, sallës sportive, fushave të tenisit dhe të ngjashme, të cilat, krahas studentëve, mund të përdoren në të njëjtën kohë nga turistët për rekreacion dhe aktivitete sportive.

Prandaj, potenciali malor, afërsia me qytetin, integrimi i sektorëve të tjerë si arsimi, sporti, trashëgimia kulturore dhe lidhja me zonat e tjera e bëjnë këtë zonë shumë tërheqëse, gjë që ndikon edhe në tërheqjen e tregut në rajon dhe në të gjithë Evropën.

Siç është përmendur tashmë, komuna e Pejës ka një ofertë të pasur turistike, që veçanërisht thekson produktet turistike në fushën e turizmit aktiv. Më të përfaqësuarat janë: alpinizmi, ngjitjet e lira, ecjet mbi dëbore, ski në pistën e skive dhe jashtë pistës së skive, si dhe produktet turistike atraktive Via Ferrata dhe Zip linja.

Via Ferrate Ari, Mat dhe Merimangat

Ari dhe Mat janë dy Via Ferrata, të parat të ndërtuara në Kosovë. Këto ferrata kanë sistem kabllor të ndryshëm nga Via Ferrate Berim në Zubin Potok, gjë që e bën ngjitjen më të lehtë. Njëra ferratë shkon paralelisht me lumin dhe tjetra vertikalisht.

Via Ferrata Ari është produkti më i përparuar i aventurave në Pejë. Megjithëse ky aktivitet është i mbushur me adrenalin, për ngjitje nuk kërkohet asnjë trajnim paraprak. Rreth 90% e alpinistëve që u ngjiten në Via Ferratën Ari e kishin për herë të parë. Alpinistët thonë se nga kjo ferratë zemra rreh shpejt ndërsa ngjiteni vertikalisht në shkallët metalike lart mbi Grykën e Rugovës. Gjatë ngjitjes, shijohen pamje fantastike të maleve përreth.

Via Ferrata Mat është shteg më i ri dhe i ndërtuar pas Via Ferratës Ari, e cila ka një trajektore rruge më të lehtë horizontale paralel me lumin dhe ofron pamje magjepsëse të grykës. Vështirësia ngjitjes në të dy ferratat është e njëjtë, por secila ka sharmin e saj unik.

Via Ferrata Merimangat është më e madhja në Pejë dhe ka një urë varëse, të ashtuquajturin Ura Tibeti, 40 metra e gjatë dhe 60 metra e lartë. Kjo ferratë fillon me atë urë dhe ngjitja zgjat midis 3 dhe 4 orësh. Përveç një entuziazmi të madh, kjo ferratë kërkon forcë fizike, pasi është shumë më i gjatë se dy të tjerat. Via Ferrata Merimangat u hap në vjeshtën e vitit 2019.

Është e rëndësishme të theksohet se për asnjë ferratë në Pejë nuk kërkohet përvojë paraprake në ngjitje. Para fillimit, alpinistët i marrin të gjitha informacionet teknike dhe të sigurisë. Kompania që i ofron shërbimet e ngjitjes me ferratë i ofron edhe pajisjet e prodhuara në Bashkimin Evropian, të certifikuara sipas standardeve të BE-së. Kompletet e pajisjeve përfshijnë një helm, rripin e sigurisë dhe setin për ngjitje ferrata. Mund të merren edhe dorëzat nëse alpinisti ka kërkesa të tilla.

Linja zip - Merimangat

Traversa e Tirolit apo linja zip u ndërtua nën mbikëqyrjen e ekspertëve ndërkombëtarë dhe më pas u certifikua nga konsulenti ndërkombëtar. Linja e zipit shkon paralelisht me lumin dhe grykën, duke ofruar pamje të grykës nga perspektiva e zogut.

Linja zip në Pejë është me e gjata në regjion. Gjatësia 700 metra përshkohet në më pak se një minutë dhe kjo përvojë do t'ju ofroi pamjen më mahnitëse të Grykës së Rugovës. Kjo është e vetmja linjë e madhe zip në Kosovë dhe është certifikuar nga organizata ndërkombëtare. Linja zip përdor pajisje të prodhuara në SH.B.A. dhe drejtohet nga një staf profesional. Në linjën zip mund të arrihet nga qyteti me makinë ose thjesht duke ecur nëpër zona të emëruara si "*shtigje shëndetësore*".

Ngjitja e lirë

Gryka e Rugovës ka shumë vende tërheqëse dhe të përshtatshme për ngjitje në shkëmbinj, ku alpinistët vendas por edhe të huaj i kanë disa shtigje me vështirësi të shkallëve të ndryshme. Gjatë viteve të kaluara, këto shtigje janë bërë edhe afër rrugëve lokale, kështu që për këtë lloj aktiviteti alpinistët nuk kanë nevojë të hyjnë thellë në bjeshkë. Shumica e rrugëve fillojnë nga gryka, e cila ndodhet pesë kilometra larg qytetit të Pejës, ndërsa të tjerat janë afër fshatrave Drelaj dhe Reka e Allagës. Pajisjet për ngjitje mund të merren me qira nga operatorët vendas të turneve, ndërsa klubet lokale të ngjitjes gjithashtu ofrojnë shërbim partneri ose udhëzuesi për ngjitje.

Alpinizmi

Në rajonin e Pejës ka shumë mundësi shëtitjeje në bjeshkë. Qyteti është i rrethuar nga bjeshkët tek të cilat mund të arrihet direkt nga qyteti në turnetë e lehta, ndërsa turnetë më serioze kërkojnë udhëtim me makinë nga 20 deri në 40 minuta. Ecja mund të organizohet me udhëzues ose pa të. Nga Peja mund të lidheni me rutën Majat e Ballkanit dhe Via Dinarika. Rruga e shëtitjes nga Peja është e lidhur edhe me grykën e Rrugës si pjesë e Bjeshkëve të Kelmendit. Kjo grykë është pjesë e Bjeshkëve të Kelmendit dhe e përfshin rajonin rreth shtratit të lumit Lumbardh (Bistrica) i Pejës. Këto maja, shkëmbinj dhe lugina, me 13 fshatra, janë kryesisht të banuara vetëm gjatë verës. Shëtitja – ecja më interesante në Rugovë është maja e Hajlës, 2403m e lartë. Kjo majë shënon edhe kufirin me Malin e Zi. Maja e Hajlës është kreshtë malore shkëmbore, e rrethuar me pyje dhe fusha. Është e pasur me florë dhe faunë. Gjithashtu, në sezon të vitit shfrytëzohet edhe si kullotë.

Snowshoeing – ecje mbi dëborë

Snowshoeing është një nga ofertat më tërheqëse në rajonin e Pejës, duke pasur parasysh që natyra ka dhuruar shtigje të përshtatshme për këtë aktivitet. Terrenet më të përshtatshëm gjenden afër fshatrave Bogë dhe Koshutan. Kur në këtë zonë ka dëborë, një numër i madh i operatorëve turistikë e përfshijnë këtë aktivitet në ofertat e tyre. Në thelb është turne njëditor që mund të kombinohet me ngjitje dimërore në majat bjeshkëve të Kelmendit (bjeshkët e Nemuna). Sidoqoftë, turnetë si kjo mund të zgjasin edhe disa ditë. Për këtë aktivitet, operatorët turistikë ofrojnë pajisje të nevojshme adekuate.

Ski në pistë dhe jashtë pistës

Ekziston një teleferik që është i vogël dhe kryesisht u shërben pejanëve, por edhe turistëve të huaj. Sidoqoftë, rajoni i Pejës ofron më shumë për sportet e dimrit. Disa kompani kanë ca produkte në ski turing. Rajoni mund të lidhet me Malin e Zi me rajonin e ski turingut të Plavës dhe Rozhajës.

Gjithashtu kompanitë lokale kanë arritur të kenë udhëzues të trajnuar për këtë sport. Ski turnigu është më i praktikuari në bjeshkën e Hajlës dhe në rajonin e fshatrave Bogë, Lumbardh dhe Milishec. Ski në pistë dhe jashtë pistës ofrohet në bjeshkën e Gjeravicës. Atje operon një kompani ndërkombëtare, duke organizuar turne ekskluzive në dëborë të thellë dhe lëshime individuale në shtigjet me devijime.

Parku i aventurave

Parku i Aventurave në Pejë është parku i parë i aventurave në Kosovë, i hapur në maj të vitit 2017. Parku i aventurave ndodhet në 780 metra lartësi mbidetare dhe është parku i parë argëtues i këtij lloji në natyrë. Vizitorët mund ta shijojnë shumëllojshmërinë e platformave ajrore, nivele të ndryshme peshe, shkallë litari, si dhe një luhajë (sallanxhak) të madh 17

metra të lartë, por edhe kalërim. Parku i aventurave me përmbajtjen e tij pasuron ndjeshëm ofertën turistike të zonës së Pejës.

Shpellat dhe speleologjia

Peja ofron mundësinë për të eksploruar dy shpella: Bukuroshen e Fjetur dhe Grykën (Këlcyrën) e Madhe, të cilat ofrojnë dy përvoja të ndryshme. Gryka e Madhe është shpellë më e madhe dhe më interesante në speleologji. Vizita në këtë shpellë është përvojë e veçantë dhe kërkon pajisje speciale që i sigurojnë operatorët lokalë. Grupet janë të vogla, maksimalisht prej 5 personash për t'i udhëhequr një guidë (udhëzues), pasi vizita kërkon ngjitje jo shumë të pjerrët, llamba, çizme dhe helmeta. Në shpelle nuk lejohen vizita të pavarura turistike dhe se kjo veprimtari paraqet përvojë speleologjike.

Bukuroshja e Fjetur është shpellë, të cilën mund ta vizitojnë turistët. Pas eksplorimit më të fundit në maj 2017, u zbulua se shpella e Bukuroshja e Fjetur është e gjatë rreth 3650 m. E përshtatshme për të gjitha moshat dhe nuk nevojitet pajisje speciale. Gjatë vizitës, ecet nëpër shkallët dhe shtigjet në shpellë. Vizita është e shkurtër, por interesante. Sa i përket ofertave speciale speleologjike, operatori lokal turistik speleologjik ofron shërbime shtesë. Për të gjithë ata që duan rekreacion dhe relaksim në qetësi, shëtitjet nëpër shpella janë zgjidhja ideale. Ajo që është e veçantë për këto vizita shpellash është se ato janë të organizuara në grupe më të vogla dhe përshkojnë pjesë të shpellave që nuk janë të hapura për vizita masive. Udhëzuesi është i domosdoshëm, si dhe këto pajisje themelore: helmeta, llamba dhe dorëzat. Vizitat janë të përshtatshme për çifte, grupe miqsh, kolegë pune dhe fëmijë të moshës shkollore, kështu që këto shëtitje, si aktivitet përmes të cilit bëhet eksplorim dhe shkëmbim i përbashkët përvojash, paraqesin udhëtim nëpër botën nëntokësore dhe janë një kënaqësi e vërtetë.

NDIKIMI I TURIZMIT NË DESTINACION

Karakteristikat e turizmit të qëndrueshëm janë minimizimi i ndikimeve negative ekonomike, mjedisore dhe sociale dhe të krijimi i dobive më të mëdha ekonomike për banorët lokal, duke rritur mirëqenien e popullatës dhe punësimin dhe të sigurimin e mundësisë së përfshirjes së banorëve lokalë në turizëm. Banorët lokalë duhet të përfshihen në vendimmarrje, gjë që ndikon në cilësinë e jetës së përditshme dhe kontribuon në ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, siguron përvoja të mira e të përhershme dhe të paharrueshme për turistët në kontakt me vendasit. Ndërsa lidhjet e krijuara midis turistëve dhe vendasve e forcojnë identitetin e popullsisë dhe besimin ndaj turistëve që vijnë në mes të tyre.

Ndikimet pozitive ekonomike të zhvillimit të turizmit janë vendet e reja të punës, rritja e të ardhurave të popullsisë, zhvillimi i ekonomisë lokale, stimulimi i prodhimit të mallrave në nivelin lokal, rritja e të ardhurave nga taksat në nivelin lokal, dhe rrjedhimisht rritja e standardit të jetesës. Ndikimet pozitive që mund të ketë turizmi në cilësinë e jetës janë promovimi i mirëqenies së komunitetit lokal, mbështetja e arsimit dhe inkurajimi i zhvillimit të mëtutjeshëm të kulturës, artizanatit dhe arteve, si dhe ngritja e nivelit të njohurive dhe arsimimit, që është sigurisht shumë i dëshirueshëm dhe i domosdoshëm kur bëhet fjalë për zhvillimin e turizmit në komunën e Pejës dhe Zubin Potokut.

Megjithatë, duhet të theksohet se procesi i zhvillimit të turizmit, mund të ketë edhe ndikim negativ në zhvillimin e destinacionit. Për shembull, planifikimi joadekuat, mungesa e strategjisë, mungesa e infrastrukturës dhe kërkesat e larta të tregut mund të sjellin pasoja negative në ndikimin e zhvillimit të qëndrueshëm të destinacionit. Gjithashtu, zhvillimi i shpejtë ka ndikim negativ në mjedis, duke krijuar probleme me ndotjen e mjedisit, shkatërrimin e peizazheve dhe duke ndikuar në florën dhe faunën e atij mjedisi.

Prandaj, zhvillimi i turizmit ndonjëherë mund të ketë një ndikim negativ në mjedis sa i përket degradimit të tij, kështu që mund të dëgjohet se turizmi nganjëherë quhet "gëlltitës i mjedisëve". Kjo në fakt tregon për rrezikun që zhvillimi i pakontrolluar i turizmit mund të çojë në degradim të mjedisit dhe, nga ana tjetër, një mjedis i tillë i dëmtuar do të ndikojë negativisht në zhvillimin e turizmit. Kjo konfirmon atë që u tha në fillim të punimit, që është se parakushti për zhvillimin e turizmit është mbi të gjitha mjedisi cilësor dhe i ruajtur, ose mjedis i shëndetshëm, për të cilin të dy komunat tani mund të mburren.

Flora dhe fauna, si përbërës karakteristikë të destinacionit turistik, kanë një rëndësi të madhe për turizmin. Ndërsa në këto zona, theks më i madh është vendosur në zhvillimin e turizmit aktiv, të gjitha aktivitetet që zhvillohen në natyrë mund të ndikojnë në florën dhe faunën. Prandaj, është shumë e rëndësishme që, përveç ekzistencës së rregullativës ligjore, të bëhet fjalë për ngritjen e vetëdijes, si për sektorin e turizmit, ashtu edhe për vetë turistët, që kur

konsumohen produkte të caktuara të turizmit, duhet pasur kujdes për të minimizuar ndikimin në biodiversitet. Ca nga aktivitetet që mund të ndikojnë në biodiversitetin në këto zona janë: turizmi i gjuetisë, sportet ujore, ngjitja e lirë, si dhe sportet e tjera sezonale.

Prandaj, detyra kryesore e autoriteteve lokale në promovimin e turizmit duhet të jetë krijimi i ambientit që mbështet modelet e nevojave të turizmit, në mënyrë që të maksimizohen përfitimet, nga njëra anë, dhe të zvogëlojnë ndikimet negative që mund të ketë turizmi në mjedis ose në trashëgiminë kulturore, nga ana tjetër.

PËRFUNDIM

Turizmi i qëndrueshëm është model i zhvillimit që thënë shkurt, përfshin sjellje të përgjegjshme kur bëhet fjalë për mjedisin dhe përdorimin e resurseve natyrore. Megjithëse në teori ka shumë përkufizime, një gjë e përbashkët e tyre është që zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit e synon kryesisht ruajtjen e vlerës mjedisore që është pjesë e vetë produktit të turizmit. Nga ana tjetër, theksohet edhe nevoja për të arritur një ekuilibër në të cilin plotësimi i nevojave të tanishme të turistëve nuk do të rrezikojë nevojat e brezave të ardhshëm. Bazuar në këtë, mund të konkludohet se efektet e turizmit të qëndrueshëm kanë shtrirje afatgjatë.

Krahas potencialeve të jashtëzakonshme natyrore, qëndrueshmëria në planin afatgjatë dhe ngritja e nivelit të cilësisë së shërbimeve janë thelbësore për zhvillimin e suksesshëm të turizmit në komunat Pejë dhe Zubin Potok. Ajo që është gjithashtu shumë e rëndësishme të theksohet është se koncepti i ri i zhvillimit të turizmit, i cili përqendrohet në qëndrueshmëri, është po aq i pranueshëm, si nga këndvështrimi i interesave të ofruesve të ofertave të turizmit, ashtu edhe i bartësve të kërkesave së turizmit.

Për zbatimin e suksesshëm të turizmit të qëndrueshëm në praktikë, është shumë e rëndësishme që komuniteti lokal të njohë përfitimet që do të ketë dhe të krijohet një lloj partneriteti midis sektorit privat dhe komunitetit lokal. Një nga dallimet e rëndësishme midis situatës aktuale në këto komuna dhe konceptit të ri të zhvillimit të turizmit, është që aktorët të cilët aktualisht janë të lidhur dobët mes veti. Kurse koncepti modern i zhvillimit nënkupton partneritetet dhe ndërlydhje në mes të gjitha palëve me interes (autoritetet lokale, përfaqësuesit e sektorit të turizmit, popullsisë lokale dhe turistëve). Megjithëse në të kaluarën ka pasur iniciativa në lëmin turistik në këto komuna që kanë nxitur bashkëpunimin midis aktorëve të ndryshëm, siç është projekti i lartpërmendur rajonal "Mokra Gora - një perlë e pazbuluar në rrugën Via Dinarika", është akoma e nevojshme të vazhdohet të punohet në këtë drejtim.

Është me rëndësi të madhe që planifikimi i turizmit të jetë integral dhe strategjik, mbi të gjitha gjegjës dhe në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit. Nëse realizohet pjesa më e madhe nga përmbajtja e dokumenteve ekzistuese strategjike, komunat Pejë dhe Zubin Potok mund të bëhen konkurruese në tregun turistik gjatë gjithë vitit, dhe jo vetëm në sezon. Me qasje strategjike, oferta turistike e këtyre komunave mund të rumbullakohet dhe vihet në funksion sa më shumë që të jetë e mundur për realizimin më të mirë të kërkesave turistike, me përdorim të qëndrueshëm të të gjitha burimeve natyrore që posedojnë këto zona.

Meqenëse kjo qasje ndaj menaxhimit të turizmit është relativisht e re, përqendrimi që ia kushton mbrojtjes së mjedisit i kontribuon pranimit më të mirë të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit si të tillë. Megjithëse qëndrueshmëria në turizëm si një qëllim përfundimtar në praktikë nuk mund të arrihet kurrë plotësisht, sigurisht që është diçka që duhet të synohet në çdo aspekt në të ardhmen.



**INSTITUTI PËR ZHVILLIMIN
EKONOMIK TERRITORIAL (INTER)**
KOLAŠINSKIH KNEŽEVA BB
ZUBIN POTOK
OFFICE@REGIONALNIRAZVOJ.ORG
WWW.REGIONALNIRAZVOJ.ORG